



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË RREGULLORES

RELACION

“MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT BASHKIAK BERAT”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015, “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 54/1 si dhe në mbështetje të shkresës Nr.540/1 Prot, dt.19.12.2019 nga Agjensia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore, del e nevojshme miratimi e një rregulloreje të Këshillit Bashkiak Berat, kjo në kuadër edhe të Forcimit, Organizimit dhe Funkcionimit të Këshillit Bashkiak. Me vendimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Berat, dt.26.12.2019 u ngrit Komisioni i Shqyrtimit të Rregullores, i cili u mbledh me datë 28. 01.2020, ku pasi mori në shqyrtim Draft -Rregulloren propozoi disa ndryshime në lidhje me përshtatshmërinë e këtij drafti në funksion të Këshillit Bashkiak Berat.

Komisioni diskutoi dhe u ndal në disa pika të domosdoshme të cilat propozon sot të ndryshohen, duke ju njohur dhe ju me propozimet tona përpara miratimit të Rregullores. Ndryshimet preken nënë të ndryshme të Rregullores të cilat po I paraqesim si më poshtë”

1. **Neni 24 Sekretariati** – Në pikën 1 të Nenit do të parashikohet 1 punonjës Pika 3 dhe pika 5 e nenit hiqen.
2. **Neni 25 Kriteret e Sekretarit të Këshillit** – Ndryshohet pika 1/c në lidhje me eksperiencën duke e zëvendësuar me togfjalëshin “me jo më pak se 2 vjet pune në administratë”.
3. **Neni 33 Emërtimi I Komisioneve të Përhershme-** Të kryhet zëvendësimi në rregullore me Komisionet ekzistuese që ka Këshilli aktual
4. **Neni 34 Funkcionimi i Komisioneve të Përhershëm** – shtese në nen togfjalëshin “Mos miratimi i ProjektVendimit në Komision nuk përbënë shkak për mosparaqitjen e materialit për në Këshillin Bashkiak”.
5. **Neni 36 “Kontrolli nga Komisionet e Përhershme i veprimtarisë së Administratës së Bashkisë”** – Pika 1 jo më vonë se 2 ditë

6. **Neni 56 “Të drejtat dhe Detyrat e Sekretarit të Këshillit Bashkiak”**- Tek pika 2 e nenit hiqet paragrafi I katërt duke qënë se është I dubluar me paragrafin e parë. Pika 4 hiqet.
7. **Neni 106 “Shpallja dhe Hyrja në fuqi e Akteve”** – në cdo pikë të nenit ku përmendet Holli I Bashkisë zëvendësohet me Zyrën me Një Ndalesë, tek pika 3 e nenit hiqet fjala “gazetë zyrtare”. Pika 11 e nenit ndryshohet si vijon “Aktet dhe Njoftimet zyrtare të Këshillit botohen në Faqen Zyrtare të Bashkisë Berat”
8. **Neni 113** – Ndryshon emërtimi I tij do te quhet “Rregjistri elektronik I Akteve të Këshillit”, si dhe në cdo pikë të nenit fjala “Gazetë Zyrtare” zëvendësohet me fjalën Faqja Zyrtare e Bashkise.
9. **Neni 116 “Shpërblimi dhe Rimbursimi I Këshilltarëve”**- Fjali e dytë e pikës 1 të nenit hiqet
10. **Neni 118 “Raportimi I Shpenzimeve vjetore të Këshillit”** – tek pika 7 e nenit fjala “kryhet” zëvendësohet me “Ndiqet”.
11. **Neni 124 “Shërbimi I Sigurisë në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit”** – pika 2 zëvendësohet me togfjalëshin “të paktën 1 punonjës”
12. **Neni 158 “Marrëdhëniet me Kryetarin”** – togfjalëshi jo më vonë se 10 ditë pune zëvendësohet me jo më vonë se 5 ditë pune
13. **Neni 180 – Hiqet**
14. **Neni 181 “Miratimi dhe Hyrja në fuqi”** – Ndryshohet “ Kjo rregullore miratohet me votim Pro të shumicës së të gjithë anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe hyn në fuqi më 1 Mars 2020.

Rëndësia e miratimit të Rregullores së Këshillit Bashkiak Berat, konsiston në rolin mbikëqyrës dhe monitories që do të ketë Këshilli ndaj performancës së Administratës Bashkiake në raport me vendimet e Këshillit dhe pritshmëritë e qytetarëve. Ky ndryshim ligjor e vendos Këshillin Bashkiak Berat në një pozicion të ri, në veprimtari të plotë vendimarrëse si organ përfaqësues i interesave të Komunitetit.

KRYETARE E KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË RREGULLORES

ELONA HOXHA

